

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Dalesë / Izlaze, Date / Dana: 08 / 09 / 2020		
Nr. Orgv. Org. jed: 01K	Nr. Prot. Br. Prot. 91	Nr. Faqeve. Br. Strana. 27
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA E PROKURIMIT
 KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
 PROCUREMENT OFFICE

Tel.: 038 200 46 045
 E-mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net
 Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË (Shërbime)

TITULLI I KONTRATËS:

LLOT I- Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas.

NUMRI I PROKURIMIT: 656-19-9557-2-2-1

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË, KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA

PJESA I. E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Komuna Ferizaj në vazhdim ("Autoriteti Kontraktues") të cilën e përfaqëson Feim Ibrahimimi në cilësinë e Udhëheqësit të Zyrës së Prokurimit, dhe në njërin anë:

"Endriti" Sh.p.k nga Ferizaj me numër të regjistrimit të biznesit 810519043 të cilën e përfaqëson z.Isuf Sejdi në cilësinë pronarit (në vazhdim "Kryesi i shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike kornize për: LLOT I- Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas

Titulli i kontratës: KONTRATËN PUBLIKE KORNIZË: LLOT I-Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas.

Nr. i prokurimit	656-19-9557-2-2-1
Nr. i brendshëm	656-19-176-221

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve (shih Aneksin 1 për përshkrimin e këtyre produkteve dhe sasi të parashikuar që mund të dorëzohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës publike kornizë).

Komuna Ferizaj bënë blerjen në emër të specifikuar në Aneksin 7.

Përdorimi i kësaj Kontrate Publike Kornizë është obliguese për të gjitha Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

1.2 Kjo kontratë publike kornizë do të implementohet nga data e nënshkrimit

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 që të furnizojnë ndonjërin prej tyre, ndonjërin prej tyre. Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 me të drejtë të tij mund të kërkojë shërbim më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara.

1.4 Nënshkrimi i kontratës publike kornizë nuk imponon obligim mbi asnjërin Autoritet Kontraktues të identifikuar në Aneksin 7 për të blerë sasi të parapara në Aneksin 1. Kryesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do të lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të kërkojë shërbim parapara të specifikuar dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendosë të MOS regjistrojë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Zbatimi i kësaj kontrate kornizë do të fillojë me nënshkrim nga të dyja palët. Kjo kontratë kornizë ka kohëzgjatje prej **(24) Njëzetë e katër muaj**.

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për fillimin e shërbimit, LLOT I-Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas, fillon nga data e nënshkrimit të kontratës

2.2 Vendi i shërbimeve: në territorin e Komunës së Ferizajt, LLOT I-Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina

Neni 4 Çmimi

4.1. Vlera e kontratës kornizë për: LLOT I- Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas, është 99,00 Euro (Nëntëdhjetë e nëntë euro e zero cent), në kohëzgjatje prej 24 muaj duke respektuar çmimet për njësi të paraqitura në Ofertën Financiare të Kontraktuesit.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoritetet Kontraktuese të specifikuar në Aneksin 7 i kanë borxh kryesit të shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi të referuara në Nenin 4.1 të lartë përmendur janë fikse dhe nuk i nënshtrohen ndryshimeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i kryesit të shërbimeve duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Aneksi nr. 1 - Specifikat teknike të Detyrueshme
- (g) Aneksi nr. 7 - Lista e Autoriteteve Kontraktuese
- (h) Urdhër blerjet

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet cilitdo Autoritet Kontraktues të specifikuar në Aneksin 7, nga njëra anë dhe kryesit të shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Në të gjitha këto komunikime Komuna Ferizaj duhet të njoftohet (Cc-ed) në mënyre që të përcjell zbatimin e kontratës.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në 4 (katër) origjinale, dy origjinale për Komuna Ferizaj dhe një origjinal për kryesit të shërbimeve. Një kopje e nënshkruar e kontratës do të dorëzohet secilit Autoritet kontraktues të specifikuar në Aneksin 7 nga Komuna Ferizaj.

Në bazë të shkresës nr.4036/19 të datës: 11.11.2019 Drejtoria e Arsimit nga Komuna Ferizaj, për nënshkrimin e kontratave kornizë për LLOT I-Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas, Drejtoria përkatëse merrë përgjegjësinë për sigurimin e buxhetit për përmbushjen e kontratës sipas kushteve të parapara me kontratë.

Përgjegjës për zbatimin e kërkesave ligjore të LPP-se Nr. 04/L-042 janë personat kompetent të Komuna Ferizaj të autorizuar për kryerjen e këtyre procedurave të prokurimit.

Për Kontraktuesin:

"Endriti" Sh.p.k

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna Ferizaj

Emri:	z. Isuf Sejdi
Pozita:	Pronar
Nënshkrimi:	 Sh.p.k ENDRITI
Data	08.09.2020
Vula:	

Emri:	z. Feim Ibrahim
Pozita:	Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	08.09.2020
Vula:	

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet /Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Ferizaj.
Gjuha e komunikimit	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe .
Dhënia e dokumenteve	5	N/A
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	N/A
Obligimet e përgjithshme të kryesit të shërbimit	7.1	Kryesi i shërbimeve duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe me përgjegjësi të plotë dhe duhet të bëjë shërbimin për LLOT I -Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas.
Obligimet e përgjithshme të shërbimit	7.4 Dhe 7.5	Kontraktuesi do të emëroje një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e kryesit të shërbimeve për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jetë në dispozicion çdo herë që kërkohet dhe do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Siguria e ekzekutimit	8.1	Kryesi i shërbimit, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, do të dorëzojë tek Komuna Ferizaj një sigurim për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së parashikuar. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 1,000.00 € (për 25 muaj) valid deri më 07.10.2022
Sigurimi	9.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Periudha e ekzekutimit të detyrave	12	Kjo kontratë hyn në zbatim në momentin kur merret vendim nga Ministria e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2020-2021, sipas kërkesës së Organit Mbikqyrës. 24 (njëzet e katër) muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate deri më 07.09.2022.
Suspendimi	15	
Cilësia e shërbimit	16.2	Kryesi i shërbimeve obligohet që të kryej LLOT I -Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj – Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas sipas ofertës financiare të ofruar nga OE dhe pasi të nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Autoritetit Kontraktues do të konsiderohet si shërbim i pranuar.
Inspektimi dhe testimi	17.1	AK cakton organ mbikëqyrës për monitorimin e shërbimeve të ofruara; Mukadeze Sylejmani - zyrtare në Drejtorinë e Arsimit.
	17.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e ekzekutimit të shërbimit në përputhje me Nenin 17 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuar në Nenin 2.2 të Kontratës kornize
Pagesat	18	Pagesa do të bëhet nga ana Drejtorive për të cilat është kryer shërbimi vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje të vlefshme të lëshuar nga cilido autoritetet kontraktues i specifikuar në Aneksin 7. Kërkesat për pagesë do të bëhet sipas shërbimeve të kryera dhe lëshimit të faturës për drejtorit përkatëse.


		<p>Pas përfundimit të çdo shërbimi kryesi i shërbimeve duhet të dorëzoj tek AK një faturë origjinale dhe nga një kopje fletedërgesës-fletëpranimit për shërbimin e kryera. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në € /Euro/.</p> <p>Çdo faturë duhet të përmbajë të paktën informacionin e nevojshëm.</p>
Vonesa ne pagesa	18.5	<p>Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18 do t'i japin të drejtë kryesit të shërbimeve që të ndërpresë shërbimin e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues përkatës-Komuna Ferizaj.</p>
Dorëzimi	19.3	N/A
Verifikimi i operimeve	20	N/A
Pranimi i përkohshëm	21	<p>Autoritetet Kontraktuese të specifikuar ane Aneksin 7 nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm.</p>
Pranimi përfundimtar	22	<p>Pas shërbimeve të kryera edhe lëshimi i faturave.</p>
Obligimet garancionit	23	<p>Kryesi i shërbimeve do të garantoj që shërbimet do të jenë profesionale. Kryesi i shërbimeve do të garantoj që as një nga shërbimet të mos kenë defekte</p>
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	26	<p>Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë kryesi të shërbimeve 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme;</p> <p>a) kur kryesi i shërbimeve në mënyrë përmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;</p> <p>b) kryesi i shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;</p> <p>c) kryesi i shërbimeve i refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues.</p>

		d) Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës ,OE nëse nuk i përmbahet kushteve të kontratës, mbikqyrësi do të shqiptojë vërejtje me shkrim. Vërejtja e tretë me shkrim nga ana e mbikqyrësit të projektit do të pasojë me shkëputje të njëanshme kontratës nga ana e Autoritetit Kontraktues.
Ndërprerja e Kontratës nga Kryesi i shërbimeve	27	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues - Komuna Ferizaj,
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në pajtim me ligjin e Kosovës. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.

LLOTO 1 - Paramasë për kryerjen e transportit publik të nxënësve me gjendje të rëndë ekonomike

Nr	Relacioni	Njësia/udhëtar	Sasia	Çmimi/ Mujore	Shuma
1	Ferizaj - Jezercë - Ferizaj	nxënës	1	1	1
2	Ferizaj - Nerodime - Ferizaj	nxënës	1	15	15
3	Ferizaj - Manastire - Ferizaj	nxënës	1	15	15
4	Ferizaj - Balaj - Ferizaj	nxënës	1	15	15
5	Ferizaj - Pleshin - Ferizaj	nxënës	1	10	10
6	Ferizaj - Zaskok - Ferizaj	nxënës	1	1	1
7	Ferizaj - Dubravë - Ferizaj	nxënës	1	10	10
8	Ferizaj - Topojan - Ferizaj	nxënës	1	1	1
9	Ferizaj - Gaçkë - Ferizaj	nxënës	1	15	15
10	Ferizaj - Greme - Ferizaj	nxënës	1	15	15
11	Ferizaj - Doganaj - Ferizaj	nxënës	1	1	1
Shuma e përgjithëshme :					99

K. V.
 1. 
 2. 
 3. 





REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net//ferizaj>



ZYRA E PROKURIMIT
KANCELARIJA ZA JAVNE NABAVKE
PROCUREMENT OFFICE

Tel.: 038.200.46.045

E- mail: prokurimi.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

01. Nr. 227/2020

Datë: 10.09.2020

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, nenit 9 paragrafi 1 pika g), si dhe nenit 61 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, i datës 10.04.2019, Kryetari i Komunës merr:


V E N D I M PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË KONTRATËS

1. Emërohet: znj. Mukadeze Sylejmani- zyrtare në DA.
2. Titulli i kontratës: LLOT I-Transporti i nxënësve në relacionin Ferizaj, Jezerc, Nerodime, Manastirc, Balaj, Pleshinë, Zaskok, Dubravë, Topojan, Gaçkë, Greme, Doganaj dhe anasjelltas.
3. Numri i Kontratës: 01K Nr.91 të datës 08.09.2020.
4. Numri i Prokurimit: 656-19-9557-221.

Detyrat dhe përgjegjësit: Do të përgatisë një plan për menaxhimin e kontratës, të menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë, të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë, të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme, të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës, të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet, t'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Zyrës së Prokurimit dhe ta merr miratimin, të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit, të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Zyrës së Prokurimit dhe t'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Zyra e Prokurimit ose nga ZKA.

I'u dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës;
2. Zyrës së Kryetarit;
3. Zyrës së Prokurimit.



Kryetar i Komunës

Agim Aliu

Për: KOMUNA FERIZAJ
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

05005

Në emër të: ENDRITI SH.P.K, RR.CEN DUGOLLI NR 3, Ferizaj
(në vazhdim "operatori ekonomik")

Titulli i aktivitetit të prokurimit: TRANSPORTI I NXËNËSVE NË DISTANCA TË LARGËTA, DHE ATYRE ME RASTE SOCIALE

LOT 1 - TRANSPORTI I NXËNËSVE NË RELACIONIN FERIZAJ - JEZERCE, MANASTIRC, BALAJ, PLESHINË, ZASKOK, DUBRAVË TOPOJAN, GAÇKË, GREME, DOGANAJ DHE ANASJELLTAS

Numri i prokurimit: 656-19-9557-2-2-1 (Nr. i brendshëm: 656-19-176-2-2-1)

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Garancion

05005

Nr.Serik i polices: 184/20

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues; DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit; DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë-nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **1,000.00 (një mijë Euro)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkakuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **1,000.00 Euro** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri është valide deri më: 08.10.2022

Kompania e Sigurimeve "EUROSIG" Sh.a.
Rruga "2 Korriku", Nr.4, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data: 08.09.2020

